



UOGJ

Miresevini ne Universitetin Eqerem Çabej

ANKESA

Per te qene sa me afer zgjidhjes se problematikave te ndryshme mund te dergoni
e-mail: **ankesa@uogj.edu.al**



**UOGJ**

Miresevini ne Universitetin Eqrem Çabej

STUDENTET**NJOFTIM**

Universiteti "Eqrem Çabej" njofton të gjithë studentët se pushimet dimërore të studentëve do të zhvillohen në periudhën prej datës 21 dhjetor 2020 deri në 4 janar 2021. Vendimi u mor në bazë të urdhrit të rektorit të universitetit "Eqrem Çabej", në mbështetje të urdhërit nr. 393, dt 29.09.2020 të Ministrit të Arsimit.

Të nderuar studentë !

Si pasojë e përhapjes së shpejtë të Covid-19, Komiteti Teknik i Ekspertëve vendosi pezullimin e mësimdhënies në auditore. Në këto kushte njoftojmë se mësimi **muajin e parë të këtij viti akademik 2020-2021, do të zhvillohet online.**

Vendimi është marrë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bazë të përgjigjeve të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë që i cilëson **"vendet ku janë të përqendruara IAL- të vatra të larta infektimi."** "Epiderniologët argumentuan që ardhja nëpër auditorët e IAL-ve apo edhe në konviktet ku akomodohen studentët nga i gjithë vendi, do të përbënte shkas për përhapjen e infeksionit Covid-19 edhe në ato zona ku situata epidemiologjike është më e ulët" theksojnë specialistët e shëndetësisë.

Logohuni në email – et zyrtare për të hyrë në klasat online. Oraret i gjeni në faqen web, krahas manualit të përdorimit.

Per te qene sa me afer zgjidhjes se problematikave te ndryshme

mund te dergoni

e-mail: ankesa@uogj.edu.al

Na ndiqni në rrjetet tona sociale dhe në web-in zyrtar të universitetit “Eqrem Çabej” www.uogj.edu.al, për më shumë informacion.

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË KONKURSIN

Sfida Covid-19

Gara e studentëve: Sfida Covid-19

Data 1 qershor sjell në klasat dhe auditoret e universitetit tonë studentët që do të kryejnë mësimin në kushte të veçanta, me orare dhe rregulla të vendosura qartë. Mosrespektimi i tyre do të ketë penalitete për të gjithë shkelësit.

Studentët e programeve “Bachelor” dhe studentët e vitit të dytë të programeve me karakter profesional, hyrja për në institucion – ora 08:00. Studentët e programeve të ciklit të dytë “Master”, “Master Profesional” – ora 10:00.

Hyrja do të bëhet nga hyrja kryesore e ambienteve të jashtme të universitetit, duke eliminuar dy hyrjet anësore. Të gjithë do të hyjnë me rradhë një nga një me largësi 1.5 deri në 2 metra. Para hyrjes do të kryhet:

- a. verifikimi i temperatures
- b. verifikimi i pajisjes me maskë dhe doreza personale
- c. Sprucimi me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duard. Identifikimi i çdo personi në bazë të listave të studentëve, personelit akademik apo stafit administrative.

Studentët me shenja të sëmundjes, simptoma të ngjashme apo temperaturë këshillohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të informojnë sekretarinë mësimore përmes telefonit. Sekretaria mësimore informon në dekanat për çdo rast të evidentuar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR
ARSIMIN, SPORTIN DHE RININËDREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT
RREGULLATOR

Nr. 3938/1 Prot.

Tiranë, më 06. 8. 2020

Lënda: Kthim, përgjigje

UNIVERSITETIT "EQEREM ÇABELI"

Rruga "Studenti", lagja "18 shtatori", Gjirokastër

Në përgjigje të shkresës suaj, me lëndë "Ridërgim i kërkesës për përfshirjen në profesionin e rregulluar të mësuesit, për profilin "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës", protokolluar në MASR me nr. 3938, datë 22.07.2020, ju informojmë se kërkesa juaj është trajtuar nga MASR përmes shkresës me numër 455 prot., datë 17.1.2020 drejtuar Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Sipas shkresës së sipërcituar, studentët, që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë "Bachelor" në programe studimi të fushës së edukimit dhe programin e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" në "Mësues ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës", pranojnë në provimin e shtetë, në profesionin e rregulluar të mësuesit, në profilin "Arsim special".

DREJTORI I PËRGJITHSHMË

Alqi KASHI

